



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 79 datë 29-08-2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË
DATËS 31 KORRIK 2025**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 31.07.2025 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 31 korrik 2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-08-2025

KRYETARË

Ana VERUSHI



-PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 31 KORRIK 2025

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 25

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 25

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe drejtorë të administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, rendi i ditës është shpërndarë, kush është dakort?

Këshilltar L.Petri; Për procedurë, znj.kryetare do propozoja një pikë në vendosjen e rendit të ditës që lidhet me një shqetësim të sipërmarrësve pasi ju është dhënë një afat që me ngut të heqin strukturat jashtë objekteve të lokaleve dhe mendoj se ne si këshilltarë kemi të drejtën dhe ligjimitetin për të diskutuar për këtë çështje pasi ka erdhur një kërkesë në gjykimin tim e padrejtë për ta, në pjesën dërmuese janë njerëz që paguajnë rregullisht tarifën dhe respektojnë marrëdhënien kontraktuale me Bashkinë dhe tashme papritur ju duhet që të ndërmarrin këtë veprim i cili ka një kosto, kohën që do ju duhet të heqin këto dhe do ngelen pa punë dhe si për koston e materialeve dhe si për faktin që lidhet me sezonin turistik. E dyta lidhet me një kërkesë që ka bërë znj.Spiro drejtuar kryetarit të Bashkis dhe këshillit, ajo e ka dërguar në datën 4 dhe ne si këshilltarë nëpërmjet emailit jemi vënë në dijeni 20 ditë më vonë në dijeni. Pse kjo vonesë?

Është e udhës të njoftohemi njëkohësisht përderisa na drejtohen dhe ne ankesat, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit dhe ju për shqetësimin që ngritët ja u kam thënë edhe në mbledhjet e tjera të mëparshme, në rendin e ditës vendosen materialet që kërkojnë vendimmarrje, ndërsa gjitha kërkesat e tjera apo shqetësimet që kemi si qytetarë dhe përfaqësojmë komunitete të caktuara, apo edhe kërkesat e ardhura nga ana e qytetarëve shqyrtohen në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, ne vëret bëmë mbledhje jashtë radhe por kjo mbledhje ishte me një tematikë të caktuar dhe nuk vendosen në mbledhjet jashtë radhe kërkesa-ankesa të qytetarëve, unë kam një sërë kërkesa-ankesa të cilat do i trajtojmë pasi të mbarojmë materialet e rendit të ditës në pikën ku ka kërkesa-ankesa të qytetarëve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush është dakort me rendin e ditës?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

"PËR MIRATIMIN E DORËHEQJES SË KËSHILLTARES ISEMRALDA SEIDOLLI".

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Drejtuar këshillit Bashkiak, lëndra dorëheqje nga funksioni i anëtarit të Këshillit Bashkiak, e nderuar kryetare dhe anëtar të Këshillit Bashkiak me anë të kësaj shkrese në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë funksionimin e pushtetit vendor ju paraqes zyrtarisht dorëheqjen time nga detyra e anëtarit të Këshillit Bashkiak Korçë nga data e depozitimit të këtij dokumenti, ky vendim është marrë pas një reflektimi të gjatë profesional, duke vlerësuar me përgjegjshmëri të plotë rrethanat, bindjet e mia, gjatë ushtrimit të këtij funksioni kam pasur mundësi të kontriboj në proceset vendimmarrëse që kanë synuar përmirësimin e shërbimeve dhe jetës të qytetarëve të Bashkisë Korçë. E konsideroj këtë periudhë një përvojë të vlefshme në shërbim të interesit publik, shpreh mirënjohjen time, bashkëpunimin korrekt me kolegët anëtarë të Këshillit Bashkiak, strukturat administrative dhe gjithë aktorët institucionalë me të cilët kam pasur ndërveprim gjatë ushtrimit të mandatit tim, në përfundim dëshiroj të theksoj se angazhimi im qytetar dhe vullneti për të ndihmuar komunitetin do vazhdojnë në forma të tjera përfshirë ndërprerjes të këtij funksioni specifik, Ju falenderoj për mirëkuptimin dhe ju uroj suksese në vijim të punës tuaj, faleminderit!

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush është dakort me dorëheqjen e këshilltares, është vendimi i saj i pakthyeshëm?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

"PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 26 QERSHOR 2025 DHE MBLEDHJES SË DATËS 21 KORRIK 2025".

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-30 QERSHOR 2025.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem

Këshilltare A.Taho: Për muajin qershor janë 41 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike dhe po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 15 familje, dhe përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor 16 familje, kemi 6 familje më pak këtë muaj, familje të cilat do riaplikohen dhe me riaplikimin do të rifuten në skemë muajin e ardhshëm. Komisioni është mbledhur ditën e henë dhe kemi vendosur t'ja kalojmë këshillit për miratim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 NË NIVEL PROGRAMI.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka dërguar për miratim tavanet përfundimtare të shpenzimit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, të rishikuar nga faza e parë e cila ishte e miratuar nga Këshilli në datën 27 mars 2025, ky rishikim ka një ndryshim në vlerën 8 milion lekë për periudhën 2026-2028 e cila është tek transfertat e pakushtëzuar sektoriale për menaxhimin e mbetjeve, ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se dhe ju jeni në dijeni sepse është bërë edhe një pyetsor lidhur me këtë pikë dhe gjitha sygjërimet e dhëna janë dërguar ekzekutivit për tu reflektuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka lidhur me këtë pikë?

Këshilltar L.Petri: Doja të dija nga komisioni më specifikisht se çfarë ndryshon, ne po ftojmë të miratojmë tavarat e përfundimtare ndërkohë që ju thoni ka pasur sygjërimet edhe do reflektohet pra ato nuk janë reflektuar këtu i bie. Mund të na bëni një sqarim se çfarë ndryshon në programe në sasi dhe %? Faleminderit.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Siç e përmendi dhe Altini ndryshimi i vetëm është rriten burimet e financimit me transfertën e pakushtëzuar sektoriale për menaxhimin e mbetjeve e cila në fazën e parë nuk është paraqitur për shkak se në sistemin e menaxhimit financiar është ngarkuar me vonesë dhe nuk arriti të futej në tavanet përgatitorë, u fut në ato përfundimtarë i vetmi ndryshim është ky, ndërsa për sa i përket sygjërimeve unë sot në mëngjes e mora si material por këto do reflektohen sepse Tavani përkufizon kufirin maksimal të shpenzimit që do të thotë brenda këtij kufiri do pasqyrohen këto propozimet që janë bërë për arsimin, infrastruktura rrugore, shërbimet publike do shikohen brenda zërave ndërsa ky ishte kufiri i shpenzimeve sipas programeve dhe gjitha këto do pasqyrohen kur të hartohen kërkesa buxhetore që shumë shpejt do vijë në Këshill faza e dytë e cila është faza teknike për hartimin e PBA-së.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj ishte sqarim i plotë, nëse nuk ka diçka e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

"PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË VLERËN 243,812.5 LEKË DHE KRYERJEN E PAGESËS PËR KTHIMIN E SHUMËS NË PO KËTË VLERË PËR LLOGARI TË "TELEKOM ALBANIA" SH.A.(ONE TELECOMMUNICATIONS).

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem

Këshilltar A.Habip: Bëhet fjalë për vlerën 243,812.5 për të cilën subjekti Telecom Albania ka paguar gabimisht tek Bashkia si detyrim ndaj kontratës që ka me Bashkinë shfrytëzimin e një hapësirë pyjore, kjo shumë duhet pasqyruar si e ardhur por njëkohësisht edhe si shpenzim për t'ju kthyer subjektit në fjalë, ekzekutivi ka dërguar për ta miratuar rritjen e pasqyrave të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka lidhur me këtë pikë?

Këshilltar L.Petri: Doja të dija nga komisioni nëse arritën ta investigonin pse kishte ndodhur ky gabim?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: T'ja japim fjalën ekzekutivit ta shpjegojë.

Këshilltar A.Habip: Ne e bëmë këtë pyetje Lazjon dhe përgjigja ishte se është bërë një pagesë e vetme gabimisht në bankë, në vend të shumës të përcaktuar është derdhur një shumë tjetër që nuk i përputhet asaj vlere që subjekti i detyrohet.

Këshilltare A.Përmeti: Mund të shtoj diçka si anëtare komisioni, bashkëngjitur është dhe pjesa e faturës që kanë paguar më shumë nëse do ishin dy subjekte private do ishte më e lehtë kthimi por përse kohë ne si institucion funksionojmë me thesarin nuk mund të preket asnjë llogari pa vendim Këshilli, kjo është arsyeja.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kalojmë në të ndryshme, meqenëse këtu përfshihen dhe kërkesa-ankesa të qytetarëve, fillojmë me to meqenëse ka një numër të konsiderueshëm po i marr me rradhë, meqenëse kryetari nuk e ka është dorëzuar sot në protokolli por çështja është ngritur edhe këtu. Unë thotë jam Vjollca Mustaka banuese e Lagjes 14, Rruga "David Selenica" prej shumë kohësh unë dhe banorët e kësaj lagje kemi ngritur vazhdimisht shqetësimin tonë për gjendjen skandaloze të rrugës, është e pakalueshme jo vetëm për mjetet private por më shqetësuese është fakti se as ambulanca dhe zjarrfikësja nuk mund të hyjnë në këtë rrugë duke rrezikuar jetën e qytetarëve. Ne nuk kërkojmë dhe zjarrfikësja nuk mund të hyjnë në këtë rrugë duke rrezikuar jetën e qytetarëve. Ne nuk kërkojmë luks por kushtet minimale të jetesës dhe qasjes të sigurt në rastet emergjente, e kemi ngritur shqetësimin ndërmjet kërkesave zyrtare, emailve, kontakteve me instiucionet lokale, për këtë janë në dijeni znj, Verushi, z.Nexhipi por deri më sot nuk është marrë asnjë masë konkrete. Z.Kryetare nuk është normale që qytetarët e një lagjeje brenda qytetit të Korçës të ndihen të ndihen të braktisur nga pushteti vendor, nëse nesër ndodh ndonjë tragjedi për shkak të aksesit në këtë rrugë, përgjegjësinë do e mbani ju dhe gjithë ata që kanë qenë në dijeni dhe kanë heshtur. Ne nuk kërkojmë më premtime, kërkojmë veprim të menjëhershëm, kërkojmë që Rruga "David Selenica" të rikonstruktohet dhe të bëhet funksionale për jetën e përditshme dhe emergjencat, fjalët e bukura nuk mbulojnë asfaltin që mungon. Me respect Vjollca Mustaka, Rruga "David Selenica" Korçë!

Meqenëse zonja është këtu dhe kërkesa juaj ishte e qartë kështu që shqetësimin tuaj do e dëgjoni nëpërmjet përgjigjes që do japë kryetari duke qenë se dhe ju jeni jeni e pamundur, unë zgjodha ta vendosja të parën kërkesën tuaj, për të marrë përgjigje.

Qytetaria: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shumë faleminderit për kërkesën, rastin e njoh, jam takuar disa herë dhe me Vjollcën dhe me bashkëshortin, kërkesat janë dy, një është për zgjerimin e rrugës dhe e dyta për rikonstruksionin errugës. Bëhet fjalë për një nga zonat informale të qytetit të Korçës ku situata është ajo që është dhe për shkak të procesit të legalizimeve në atë kohë i cili nuk është bërë sipas procedurës të duhur dhe ka rezultuar duke pasur një rrugë më të ngushtë. Në lidhje me zgjerimin e rrugës në rast se bëhet fjalë për prona private do na duhet të kalojmë në procedurat e shpronësimit, para dy ditësh i kemi

bërë një kërkesë zyrtare ASHK-së ku i kërkojmë informacion për gjendjen e pasurive në këto kartelat për zgjerimin e rrugës, në varësi të përgjigjes që do marrim nga ASHK do jenë edhe procedurat për shpronësim publik, të cilat marrin një farë kohe pasi finalizohen me vendim të Këshillit të Ministrave por gjithsesi është proces që e kemi filluar. Përsa i përket kërkesës të dytë është e lidhur me pjesën e parë duhet të sqarohet dhe shpronësohet sipërfaqja që do përbëjë gjurmën e rrugës të ndërhyhet me asfaltim, por duhet ta kemi parasysh që bëhet fjalë për zona informale dhe pavarësisht dëshirës që kemi dhe kemi bërë kjo është e pamundur të realizohet brenda 1 viti. Në zonën e ish- Kunderajorit që ndodhet edhe Vjollca ne kemi ndërhyrë duke asfaltuar një pjesë, me asfaltimin e dy rrugëve dhe ka ngelur dhe kjo rruga tuaj nuk po themi që nuk keni të drejtë por ecim brenda mundësive që ka Bashkia, lajmi i mirë është se kemi mbaruar me rikonstruksionin e rrugëve brenda Unazës, kemi bërë edhe një pjesë të madhe të zonave informale, tek ish-parikimi, tek ish-smt, rruga e voskopojës dhe sërë lagjes të tjera, na kanë ngelur akoma pa bërë por jemi duke ecur. Me shpronësimin po ecim dhe në varësi të përgjigjes nga Ashk do bëjmë dhe rikonstruksionin e rrugës.

Qytetaria: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më fal Vjollca edhe ju dhe këshilltarët morën përgjigje.

Qytetaria: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Si qenka bërë urbanistika, mbaje kalin Vjollca e më dëgjio, a keni erdhur bashkë me burrin dhe vetë po e thua tani që ka nevojë për zgjerim, (nuk ka audio.). Zgjerimi i rrugës lidhet me shpronësimin i cili ka disa hapa, merret gjendja e pronave nga hipoteka në varësi të informacionit nga hipoteka fillojnë hapat e shpronësimit, bëhet projekti dërgohet tek Këshilli i Ministrave dhe del vkm-ja për shpronësim, duhet të paguajmë lekët tek ata pronarët dhe bëhet tokë shtet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Administrata po bën maksimumin, nuk varet nga ekzekutivi.

Qytetaria: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mirëmbajtje me çakull kemi bërë edhe herë tjetër dhe do vazhdojmë ta bëjmë, e keqja e rrugëve me çakull është se nuk ka efekt afatgjatë duhet ndërhyrë disa herë, siç kemi ndërhyrë herë të tjera do vazhdojmë të ndërhyjmë. Nuk ka rëndësi sa m, ka të njëjtën procedurë, të keqen nuk e solla unë, as avllitë nuk i kam bërë unë as rrugën nuk e kam ngushtuar unë. Vjollca më dëgjove çfarë thashë, respektin e kemi të ndërsjelltë sepse njihemi personalisht, ka procedura.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka erdhur një kërkesë e dytë nga z.Arjan Kacimbri, kërkesë për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për të diskutuar në lidhje me problematikën e Shoqatës të të Verbërve, fjala është për ty z.Arjan.

Këshilltar L.Petri: E kam vënë re edhe tek transmetimi online se qytetarët nuk dëgjohen dhe teknikisht do propozoja të zgjidhet ky ngërç sepse është në të drejtën e atyre që na shikojnë të dëgjohen sepse bëhet si monolog pastaj duket sikur flet vetëm z.kryetar, ose vetëm ne, megjithatë për sot mund të veprojmë kështu.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mund ta zgjedhim me mikrofon të lëvizshëm dhe mund të vendosim një nga ata djemtë që kujdesen për mirëmbajtjen e rrjetit.

Qyetari A.Kacimbri: Unë jam Arjan Kacimbri dhe unë dhe shokët tim kemi vështirësi në punësim, kam bërë universitetin, kam bërë stazhin dhe jam hequr, kemi që marr nuk më del pasi marr vetëm hequr, kemi që marr nuk më del pasi marr vetëm ilaç për sy, mamane e kam të paralizuar babai më ndroi jetë, unë po pres por nuk e di dhe sa. E dyta ne nuk kemi një zyrë, ne kemi një zyrë në rajonin 1 por nuk mund të quhet zyrë pasi as 10 persona nuk i nxë, edhe mbledhjet që bëjmë ne nuk kemi një vend, mus më është hapur dera nga respekti por ne duam 1 qendër tonë sepse prindërit po ndërojnë jetë dhe ne po ngelimi në mëshirë, ne duam një qendër ku të na bëhet 24 orë shërbim pasi qendra e moshës së tretë nuk na pranon dhe me të drejtën e tyre sepse ne nuk jemi mbi 60 vjet, ne na vet shumë kjo gjë, nesër, pasnesër mund të më ndërojnë jetë çfarë do bëj unë sepse unë nuk mund të pastroj as shtëpinë. Në datën tetor kemi ditën e shkopit të bardhë dhe do bëjmë një aktivitet, unë do ju ftoj ju sespe ju jeni të gjithë miqtë e mi dhe do ja u zë sytë gati 1 orë dhe atje do e kuptoni se sa e vështirë është mos shikosh. Problemi i fundit është ky ju faleminderit i keni hequr tarifën, taksat por 1 diçka duhet rregulluar (nuk ka audio).

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.Kacimbri, unë të ftoj të dëgjosh një përgjigje nga kryetari.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përshëndetje z.Arjan, tani në lidhje me këto problematika, patjetër sensibilitetin e kam e kemi dhe si administratë e Bashkisë për të dëgjuar në rradhë të parë por edhe për të adresuar ato problematika që një kategori në nevojë siç është kjo kategori, mund të ketë me Bashkinë apo Këshillin. Tani përsa i takon asaj kërkesës individuale të punësimit, duke pasur parasysh bërja e stazhit në institucionin e Bashkisë nuk përkthehet më pas në mënyrë automatike në punësim. Punësimi më vonë është i lidhur edhe me nevojat që ka Bashkia për staf edhe me kualifikimet që duhet të kenë në lidhje me pozicionet që ka Bashkia, duhet të kemi një vëmendje më të shtuar dhe të gjejmë mënyra sesi persona nga kategorioja juaj apo kategori të tjera, sepse kam takuar para pak muajsh edhe një djalë që ka bërë praktikën këtu ishte edhe me problematika të lëvizjes edhe jam në process reflektimi se cilat mund të jenë hapësirat dhe do përpiqemi të krijojmë hapësira. Përsa i përket kërkesës të dytë sepse ajo filloi si kërkesë për zyrë dhe një për qendër shërbimesh, për personat e kategorisë të të verbërve, përsa i takon ambineteve për zyrë ne çfarë kemi godina në ambinetet e Bashkisë dhe Bashkisë të vjetër ja u kemi vënë në dispozicion shoqatave të ndryshme për të cilat na detyronte ligji për pajisje me zyrë. Mënyrë tjetër nuk është se kemi ambiente të tjera të lira përveç ambientit ku jeni, në rast se do kemi ambient tjetër do e kemi në dispozicion, përsa i përket qendrës për shërbime specifike vlen ai diskutimi që kemi bërë në këshill në rastin tjetër që ishte grupi i nënave me fëmijë të spektirit të autizmit, kërkesa për qendra të ndryshme multifunksionale apo monofunksionale janë të mëdha ne po përpiqemi të bëjmë maksimumin me kushtet që kemi, me donatorët që na janë ofruar por po ja lemë detyrë drejtorisë të shërbimeve sociale të Bashkisë Korçë se kemi dhe përfaqësuesin këtu, të shohin mundësitë dhe me donatorët dhe praktikantët më të mira të Bashkive të tjera në Shqipëri, nuk kam informacion në rast se ka ndonjë qendër kombëtare që trajton këto rastet e personave të verbër në nivel vendi, por të marrim këtë informacion të shohim dhe praktikantët më të mira dhe të shohim se çfarë mund të bëjmë. Përsa i takon dhe shërbimit të pagesës të taksave për familjet që kanë persona të verbër dhe besoj se këtë përcaktim ka ligji, ligji ka rastin vetëm kur kryefamiljari është i verbër.

Qyetari A.Kacimbri: (Nuk ka audio.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Arjan tani këto përcaktimet ligjore ne mund t'i diskutojmë këtu, t'i japim opinionin tonë janë të drejta, duhen pasuruar por nuk i ndryshojmë ne me vendim këshilli, ta mbajmë

shënim dhe ta sygjerojmë tek Ministria e Shërbimeve Sociale në rast se mund të bëhet ndonjë ndryshim ligjor, këtë kemi në dorë ne për të bërë ato ndryshime që kërkojnë ndryshim të ligjit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Arjan. Një kërkesë tjetër ka erdhur nga një zotëri i quajtur Androkri Paskali banor në Lagjen 9, Rruga "1 maji", hyrja 2, pallati 7 parashtroj kërkesën time si më poshtë:

Banoj në një hyrje pallati bashkë me gruan, në certifikatën e pronësisë kam vënë dhe emrin e vajzës dhe të të shoqit të saj, këtë veprim e kam bërë që pas vdekjes pronën ta kenë ata, vajza jeton e ndarë nga ne që kur u martua, duke pasur parasysh gjendjen tonë ekonomike sepse marrim një pension minimal ku së bashku marrim rreth 320 mijë, gjendje shendetësore ku jam operuar nga zemra harxhojmë shumë për ulla së bashku marrim rreth 320 mijë, gjendje shendetësore ku jam operuar nga zemra harxhojmë shumë për ilaçe dhe vizita mjekësore, kërkojmë nga jut ë na lehtësoni dhe të na hiqni taksën e banesës si dhe të gjelbërimin sepse me këto të ardhura nuk e përballojmë dot jetesën, shpresoj ta merrni në konsideratë shqetësimin tonë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ideja është që këto përcaktimet për mospagim të taksave janë ose në ligj, ose në vendim të Këshillit të Bashkisë dhe janë të përcaktuara qartë kategoritë që përfitojnë dhe janë të lidhura me certifikatën familjare dhe pronësisë. Tani zotëria duhet ta zgjidhë këtë ngërç dhe të përfitojë pastaj. Nuk funksion kjo që është kot në letra dhe fakti është tjetër, duhet të përputhet fakti me dokumentat.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kërkesë tjetër e ardhur nga një qytetar Gjergji Qisko, banues në Lagjen nr.6, Rruga "Antonio Athanas" nr.78 ankohe pranë këtij Këshilli se në datën 8.07.2025 nga ana e Bashkisë Korçë me përfaqësues Lorenc Palolli më ka ushtruar forcë fizike ndaj familjes dhe më ka shkatërruar gjithë pronën private se ndoshta kam shkatërruar gjithë pronën publike duke mbjellë pemë, drurrë frutore, tjegulla që unë e kërkoj të më legazlizohet që në vitin 2005, nga ndërtimi pa leje në vitin 1995-1997 më mbetën materiale ndërtimi si gurë, tjegulla.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ta sqaroj bëhet fjalë për një nga zonat informale të qytetit të Korçës ku kemi pasur një ankesë nga një familje që zotëria që ka bërë këtë letër kishte depozituar materiale ndërtimi në një pronë publike duke i penguar kësaj familjes tjetër aksesin tek banesa e saj, është verifikuar situata dhe ka rezultuar që ka qënë kështu, në një hapësirë publike ishin depozituar materiale të ndryshme të cilat janë larguar nga ana e Bashkisë. Pretendimi i zotërisë ka qënë ajo prone vërtet është publike por unë do e marr nëpërmjet procesit të legalizimit dhe përgjigjia ka qënë për sa kohë është publike do trajtohet si hapësirë publike, në rast se do emarrësh nga procesi i legalizimit do e marrësh dhe do jetë hapësira jote.

Këshilltar E.Bregu: Është në proces legalizimi ai, ka futur dokumentat?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Besoj duhet të jetë në proces legalizimi por fakti që është në proces legalizimi nuk i jep të drejtë të zптоjë hapësira.

Këshilltar E.Bregu: Fakti që e ka në proces konsiderohet pronë publike, apo që ai e ka në zotërim?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo nuk ka asnjë informacion të tillë që ai e ka në zotëri dhe për këtë ishte shumë i qartë dhe zotëria por pretendimi i tij ishte besoj do ta marr nga legalizmi, nuk funksionon kështu.

Këshilltar E.Bregu: Që do e marr në pronësi e ka fjalën ai, unë po them në zotërim jo pronësi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo nuk i lejohej ta ketë dhe nuk mund ta trajtojë hapësirën publike si hapësirë personale, qoftë edhe duke mbjellë pemë, nuk ishin vetëm këto pasi e kishte bërë si vend depozitimi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka një kërkesë të erdhur nga këshilltari Klajdi Pllaha, kërkesa besoj se Klajdi mos ta lexoj unë jeni vetë këtu dhe ta trajtoni.

Këshilltar K.Pllaha: Kërkesa ka qënë thjesht kërkesë për informacion drejtuar Bashkisë nuk është çështje për tu trajtuar në Këshill, nëse e diskutojmë, e diskutojmë se problematika qëndron.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do merrni përgjigje.

Këshilltar K.Pllaha: E kam marrë përgjigjen, mund ta diskutojmë meqënëse është mundësia?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Prandaj thashë.

Këshilltar K.Pllaha: Kërkesa për informacion qëndronte në mënyrën si Bashkia Korçë ka marrë masa për të zgjidhur problematikën e qenve endacakë e cila është ngritur 2 vjet që kam unë në Këshill, është problem i trajtuar gjërisht dhe këtu e kemi diskutuar disa herë dhe kërkesa për informacion që unë kam depozituar tek sporteli është nëse është shpenzuar ndonjë fond, nëse është ngritur ndonjë qëndër për të strehuar qentë endacakë, a ka pasur ndonjë marrëveshje me shoqërinë civile apo me dike tjetër dhe a ka pasur raste të denoncimeve nga qytetarët që janë sulmuar nga qentë endacakë?

Për një pjesë kam marrë përgjigje, për një pjesë jo, nëse mund të bëni ju një përmbledhje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Problematika e qenve të rrugës qëndron, është një nga problematikat më shqetësuese dhe një nga gjërat me të cilat jemi marrë jo me shumë sukses për hir të së vërtetës dhe shpresoj se rezultati në periudhën afatshkurtër ta kemi shumë herë më të mirë. Kemi rikonstruktuar një hapësirë që do shërbejë për strehimin e qenve endacakë me një kapacitet të caktuar, jemi duke bërë procedurën për t'i kapur këto qentë endacakë dhe do fillojmë procesin e kapjes të kontrollit me një veteriner dhe të vendosjes tek kjo qëndra e mbajtjes të qenve endacakë. Ju kemi bërë shumë herë thirrje shoqatave të ndryshme të mbrojtjes të kafshëve në qytetin e Korçës jemi të hapur dhe më gjërë, që siç me të drejtë bëjnë sensibilizim kur shohin raste të keqtrajtimit të qenve të rrugës të përfshihen dhe në procesin e zgjidhjes të kësaj problematike duke dhënë një kontribut sado minimalist dhe fatkeqësisht më duhet ta them se gatishmëria me vepra ka qënë o, nuk kemi asnjë rast të vetëm të këtyre shoqatave që të ofrohen dhe të japin një kontribut për këtë problematikë, rastet e kafshimit nuk i kam parë vetë por nga qytetarët më është thënë se ka ndodhur, besoj se do kemi një përmirësim të ndjeshëm të situatës në një periudhë afatshkurtër.

Këshilltar K.Pllaha: Qendra do shërbejë vetëm për strehim apo dhe për sterilizim dhe matrikulimin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe për strehimin aq sa është kapaciteti.

Këshilltar K.Pllaha: Është vënë në dispozicion një staf ose, kemi marrë ndonjë masë konkrete apo janë të gjitha në do të.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ambienti është rikonstruktuar, kapja do bëhet me stafin e Bashkisë me pajisjet që i kemi prokuruar, 1javë- 10 ditë do i kemi, trajtimi do bëhet dhe me një veterinet që e kemi pjesë të

stafit, nëse na lind nevoja do angazhohet edhe një veteriner tjetër me një formë kontrate që do e shohim sipas ligjit.

Këshilltar L.Petri: Doja të dija z.kryetar ku është vendndodhja e kësaj qendre dhe pyetja tjetër nëse ju në këtë projekt jeni duke u marrë dhe me ndërgjegjësimin për të minimizuar këtë fenomen sepse është një dukuri e cila ka arsytet e veta pse ndodh braktisja e qenve, mendoj se është e udhës të punohet edhe në këtë drejtim sepse nuk mjafton vetëm një qëndër, sigurisht do ishte e udhës që është shumë për tu përshëndetur dhe ju përgëzoj nëse do ecim në këtë formë. Nga ana tjetër nëse fenomeni vazhdon, na rroftë qëndra, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Qendra është në dijeninë time në afërsi apo brenda bazës prodhuese të Shkollës Buqësore pra tek Rruga e Voskopojës, përse i takon ndërgjegjësimi është e vërtetë që të zgjidhet problem duhet parë edhe si mund të minimizohet problem i qenve të rrugës dhe problematika është më e madhe sepse kemi konstatuar që në shumë raste këta qen sillen edhe nga Bashki të tjera, personat që janë në terren më thonë që e kanë të konstatuar edhe të provuar, nuk është se kemi kapur ndonjë rast kam vënë në dijeni edhe komisaratin e policisë që të përpiqen t'i evidentojnë këto raste por fenomeni është që herë pas here shohim tufa qensh që nuk kanë qenë më parë, ndërgjegjësim duhet por nuk besoj se është mjeti më i mirë, duhet të jetë penalizimi, pra duhet të gjejmë mënyra sesi duhet t'i evidentojmë këto raste dhe të gjejmë individët që i kryejnë këto fenomene. Nuk është e udhës që një banor fshati kur i plakët qeni ta marrë ta lëshojë në qytet, duhet punuar më tepër me pjesën e sinjalizimit nga ana e banorëve sepse nuk kemi mundësi të ruajmë çdo cep të unazës ku mund të ndodhë ky fenomen, të mbajnë shënim targetet e mjeteve që mund të kryejnë këtë punë dhe të marrim masat penalizuese.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit kryetar.

Këshilltar E.Bregu: Më fal sa është kapaciteti mbajtës i kësaj qendre dhe mendon se në këtë formë do i jepet zgjidhje problemit?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit kryetar, një kërkesë tjetër që është marrë përgjigje nga z.Pllaha, është dretjuar sekretares të Këshillit, znj.kryetare në lidhje me rregulloren neni 151 dhe 125 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak vendosjen në dispozicion për gjithë këshilltarët, raportin vjetor të punës për vitin 2024 gje e cila është bërë, vendosja në dispozicion për gjithë këshilltarët e raportit të zbatimit të buxhetit të Këshillit Bashkia Korçë për vitin 2024 gjë të cilën eja ja u ka dërguar.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Në fakt në kërkesa që kishte bërë Klajdi bashkë me Lazjonin theshin që ne si Këshill nuk ekemi përgatitur raportin e performancës që sipas rregullores duhet të ishte paraqitur në Këshill deri në muajin prill por më pas folëm me klajdin dhe ja dërgova dhe rendin e ditës të muajit shkurt edhe raportin e performancës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Një kërkesë tjetër ka erdhur nga Këshilltari Lazjon përsëri për raportim drejtuar kryetares të Këshillit kërkesë për raportim nga drejtoresha e Qendrës të Artit dhe Kulturës lidhur me organizimin e Festës të Birrës bazuar në nenin 105 të rregullores të Këshillit, e nderuar kryetare në mbështetje të kompetencave që jep rregullorja e Këshillit Bashkiak Korçë neni 105 kërkojmë në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të ftohet për raportim drejtoresha e qendrës në lidhje me

organizimin e aktivitetit tradicional Festa e Blirës. Raportimi të përfshijë këto elemente të kostos totale dhe të ardhurat nga realizimi i vitit 2024, procedurat e ndjekura për tenderim, përfshirë procedurën e ndjekur për kontraktorët, artistët dhe operatorët privat, planifikimin paraprak për vitin 2025, përfshirë parashikimet buxhetore dhe strukturën e organizimit, ky raportim është me rëndësi për transparencë dhe vlerësimin institucional të një prej aktiviteteve më të rëndësishme të qytetit me ndikim të gjërë kulturor dhe ekonomik, ju lutem që kjo kërkesë të merret në shqyrtim dhe të përfshihet në rendin e ditës brenda afateve të parashikuara në rregullore. Kërkesa ka erdhur në datën 11.07.2025.

Këshilltar L.Petri: Thjesht për procedurë është z.Klajdi Pllaha dhe unë, nuk jam vetëm unë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ok se këtu Lazjoni thotë, ok dhe klajdi. Ryetar do thonë diçka apo meqënëse janë materiale voluminoze.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal këtë kërkesë unë nuk e kam parë më ka erdhur mua kjo apo i është drejtuar drejtorisë të Qendrës të ARTIT?

Këshilltar K.Pllaha: Sipas rregullores kryesia e Këshillit thëret për raportim kryetarin e Bashkisë, apo ndonjë drejtues.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal kjo i është drejtuar kryetares të Këshillit të Bashkisë.

Këshilltar K.Pllaha: Për të thirrur për raportim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk kam asnjë problem le të thirren për raportim, unë e para nuk e kam parë fare sepse kjo nuk i drejtohet kryetarit të Bashkisë dhe nuk kam çfarë material t'ju sjell tani, të thirret drejtoresh e Artit dhe Kulturës dhe t'ja u japë.

Këshilltar K.Pllaha: Mund të thirret në mbledhjen e ardhshme.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk kisha parë fare dhe shoh që ja keni drejtuar vetëm kryetares të këshillit.

Këshilltar K.Pllaha: Sepse kryetari i Këshillit duhet të bëjë thirrjen, mund të presim edhe muajin tjetër, nuk ka problem.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Një kërkesë drejtuar kryetarit të Bashkisë, bashkëlidhur kërkesa e plotë, drejtuar Këshillit, kryetares të Këshillit.

Të nderuar përfaqësues të zgjedhur të Këshillit të qytetit të Korçës dhe z.Kryetar të Bashkisë ne që po ju drejtohem jemi një përfaqësi e subjekteve që kemi aktivitetet tona në Bulevard "Republika" ku së fundmi pa u bërë me një konsultim publik apo pyetësor për bllokimin e këtij bulevardi, nëse kjo situatë do ishte dhe në të mirën tonë po ju drejtohem me një kërkesë ku kjo situatë duhet të rishikohet pasi bizneset tona ndjejnë një bllokim dhe një rënie të xhiros në masën 80 %. Si taksa pagues të rregullt e kemi të pamundur të punojmë këto tre muaj që Korça ka turistë nga brenda dhe jashtë vendit pasi dimri vjen shpejt dhe kjo xhiro në bulevard përfundon në orën 20, ju bëj me dije se rrugicat që lidhin Bulevardin "Republika" në këto ditë që është bllokuar qarkullimi janë të mbingarkuar por sjellin pengesa për banorët e lagjeve 1,2,12 dhe pengimin e plotë të aktiviteteve tona pasi pjesa dërmuese ofron dhe shërbim delivery. Shumica e subjekteve ka marrëveshje me Bashkinë për parkim publik gjë e cila del jashtë funksionit dhe nuk ka akses për turistë, kërkojmë nga ana juaj një konsultim sa më shpejt të jetë e mundur për të bërë mundësi për rishikimin e këtij vendimi në favor të gjithë qytetarëve por edhe bizneseve tona. Duje ju falenderuar për bashkëpunimin jemi në pritje të një përgjigjeje nga ana juaj.

Personat e kontaktit Nestila Spiro dhe ka një numër subjektësh që operojnë në bulevard "Republika". Ka nevojë t'i lexoj të nderuar këshilltarë?

Vog Bar, Vechia Casa, Housebrand, Farmaci 22, Diva, Secreti, Butik Flanagan, Mans Brand, Bar Amerika, Supermarket Euromarket, Vila Ekrem, Life Gallery, Cuba, Cherrbaby, Soyo Bar, Creperia, Proper Pizza, Amor Coffe Shop, Gelot, Republika Pub.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është e vërtetë që prej një periudhe të caktuar kohore është kryer bllokimi i lëvizjes të makinave nga 19:00 deri në 23:00, më duhet ta them në fillim që vendimmarrjet në këtë bulevard nuk ju takon vetëm bizneseve por gjithë qytetit sepse është aksi kryesor i lëvizjes dhe vendimmarrja duhet marrë parasysh patjetër nga bizneset që janë në atë zonë por nuk duhet të limitohet vetëm në interesin e biznesit por duhet marrë parasysh edhe interesin e gjerë të qytetit. Tani ajo që kam konstatuar unë por edhe ju besoj, në këtë orar që po flasim në periudhën e verës trafiku apo lëvizja e makinave në masën 90% realizohet kryesisht nga të rinjtë që bëjnë xhiron tradicionale me makina, e përdorin këtë bulevard për të zvendësuar xhiron e dikurshme në këmbë me xhiron me makinë për të treguar se kush e ka makinën më të mirë por për të bërë edhe nga këto historitë që bëjnë adoleshentët që nuk është se kam ndonjë gjë lidhur me këtë por që mund t'i bëjnë edhe me këmbë. Trafiku në masën 90% ka qënë i kësaj kategorie, kam pasur kërkesa të vazhdueshme nga qytetarët që k aks të bllokohet për makinat minimalisht në periudhën e verës për tu lënë i lirë këmbësorëve dhe në momentin që këto masa janë zbatuar kam marrë shumë mesazhe dhe faleminderime që e ka çliruar këtë bulevard dhe ja u ka lënë këmbësorëve. Është një masë e cila vjen në vazhdim të një mase që kemi marrë vite më parë për të bllokuar trafikun në periudhën e verës në orare të caktuara deri nga ora 20:00 që është Rruga "Rilindasit" tek Parku "Rinia" dhe tani e kemi zgjeruar edhe në bulevardin "Republika" kjo ka qënë shtysa, në reagimet që kam marrë unë nuk e di çfarë keni marrë ju e kanë mirëpritur si ndërhyrje, megjithatë jam i hapur të dëgjoj opinionin e Këshillit të bashkisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka ndonjë mendim nga këshilltarët apo sygjerim lidhur me këtë kërkesë-ankesë?

E kisha më shumë mendjen këtë dhe nuk e pashë Adën, e kam vëmendjen më shumë këtë që të përfshihen në sa më shumë diskutime.

Këshilltar E.Bregu: E dëgjova fjalën e kryetarit dhe ndoshta ai ka të drejtë që më shumë rëndësi ka interesi i gjithë qytetit sesa e një pjese të banorëve apo bizneseve por unë në këtë rast desha të kuptoj më shumë që kërkesa e tyre ka lidhje me faktin që ndikon biznesi i tyre nga kjo ndërhyrje apo jo, nëse e ka parë kryetari me këtë këndvështrim lidhur me përgjigjen që dha?

E dyta nëse nuk ka informacion të plotë ndoshta për t'ju dhënë një farë akses apo ndihme këtyre bizneseve nëse kjo ndikon vërtet, ndoshta ajo rrugë mund të bëhet me një kalim sepse mendoj se fluksi i trafikut të këmbësorëve, i personave që dalin xhiro në bulevard të gjithë jemi të vetëdijshëm që ka rënë, ne të gjithë kalojmë atje dhe rruga është bosh vetëm trotualet janë të mbushura, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, për komentin që bëtë.

Këshilltar A.Përmeti: Lidhur me çështjen që u diskutua, duke qënë se jam banor e zonës aty por edhe vëzhgues e mirë sepse çdo ditë kaloj në atë rrugë, mund të them se pavarisht se kjo nuk është vendim i Këshillit Bashkiak, zona ka shumë nëna me fëmijë që kalojnë me karrocë me fëmijët e tyre të cilët kishin shumë vështirësi për të kaluar dhe kjo nuk ndikon tek bizneset sepse gjithë bizneset aty janë me individë

dhe nuk ka mundësi të parkohen, unë çuditem nga ana e cila nuk ka parkim, por çfarë ndodhte shumica e makinave zënë rrugën dhe pengojnë qytetarët për të zhvilluar aktivitetin e tyre të mbasdites dhe një pjesë e bizneseve mbase nuk kanë lidhje me kalimin e makinave në këtë zonë dhe unë shikoj që çdo ditë këto biznese janë plot, do ishte shumë mirë që të fillonte nga Katedralja deri poshtë sepse tani është krijuar një ngërç shumë i madh i makinave të cilat vijnë deri aty mund të vërtiten dhe kthehen në dy rrugicat që lidhen me lagjet 1 dhe 12 ku jemi banues por kjo është diçka e përkohshme, të gjithë shkojnë tek Parku "Rinia" dhe ka shumë lëvizje kjo rrugë, për këtë pjesë e mbështes këtë nismë.

Këshilltar L.Petri: Zonja kryetare dhe unë mendoj se është një vendim i drejtë i Bashkisë sepse duhet thënë edhe kjo se xhiroja tradicionalisht është bërë që në kohën e Zogut në këtë bulevard edhe sa për informacion është kjo traditë që e mori më vonë dhe Tirana e inkorporoi dhe u bë mbarë kombëtare kjo traditë e xhiros. Thënë këtë nuk mund të zemë sytë dhe të themi gjithçka shkon vaj dhe unë ju mirëkuptoj edhe ju jap të drejtë sipërmarrësve atje sidomos për ata sipërmarrës, target grupin e klientëve të cilës e kanë me njerëz që shkojnë me makina, parkojnë dy minuta marrin një delivery ose diçka në dyqan dhe ikin dhe sygjërimi im nisur edhe nga prishja e lokaleve që po bëhet me ngut shoh një pikëprerje në këtë gjë sepse koha e zbatimit lë për të dëshiruar. Pse ne na mungon drita e arsyes për tu pleqëruar me këta njerëz dhe t'ju thuhet që shiko të bëhet ky takim që në shkurt dhe të thuhet se në verë duam të bëjmë këtë gjë sepse janë njerëz që marrin kredi investojnë me djersë dhe gjak dhe pastaj ju kthehet mbrapsht dhe vështirësohet gjithë ai mund. Po flas për parimin që e shoh pikëprerjen dhe e dyta tani konkretisht po flas për Bulevard "Republikën" dhe rrugët pingul është e vërtetë ajo që tha znj.Përmeti mendoj se ka vend që ky projekt të bëhet më i mirë menduar sepse nëse ne lejojmë pezullim të bulevardit për makinat që unë e përshëndes si vendimmarrje nga ana tjetër të lejojmë që në rrugët pingul makinat të futen dhe të bëjnë xhirime dhe rrezikojnë jetën e qytetarëve që nga një anë jut hemi kaloni se është pedonale, nga ana tjetër jo. Kam një sygjërim nëse e konsiderojmë të pezulluar për makinat të pezullohen edhe rrugicat që mos futen makinat në orarin që do bëhet fasha të jetë për këmbësorët.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani situata është e komplikuar dhe nuk mund të bëhen propozime fare arbitrare, të pezullosh trafikun e makinave në gjithë Lagjet 2 dhe 3 nuk mund ta bësh, patjetër që situata është dinamike në sensing po e zbatojmë tani për herë të parë dhe po mbajmë shënim çfarë janë gjëra që shkojnë dhe jo dhe vitin tjetër do e përmirsojmë mos krijohen problematika të tjera, në rast se do lihet vetëm Lagja 1,2, 3 të çfryjnë vetëm 1 ose 2 pika, një në drejtim të parkut dhe një në drejtimin nga Kinemaja krijohet problem i madh por do e shohim, realisht jam i hapur për sygjërimet, por gjithnjë të vemë këtë piketën e parë është mirë që Bulevardi të jetë pedonale, ndajmë këtë opinion si Këshill?

Këshilltar L.Petri: Po.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund ta bëjmë këtë diskutim më të gjërë kur të vijmë tek pika e shëtitores e kësaj pedonale, mund t'i kishim lajmëruar më parë çfarë do ndryshonte?

Këshilltar L.Petri: Fjala vjen unë drejtoj një sipërmarrje delivery për kafe dhe më thuhet 4 muaj para nga njësia vendore se në verë morëm një vendim për mbylljen e bulevardit, unë paraqes projekt inovativ sesi do i qasem klientëve, fitoj kohë, gjej gjetje tjetër sesi do shkojë produkti tek klienti.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ke të drejtë që në parim njoftimi duhet të bëhet më shpejt, në rastin konkret unë kërkesat i kam pasur të hershme por propozimi final me ka erdhur nga policia e qarkullimit rrugor që më kanë thënë se 90% e trafikut janë njerëz që vërtiten kot bëjnë xhiro me

makina dhe e kemi parë si testim një fundjavë dhe kemi parë se nuk ka ndodhur ndonjë çudi në sensing e shtimit të trafikut në pjesë të tjera thjesht ata që vërtiten kot nuk u vërtiten më, kjo ishte ajo që ndodhi, në parim bie dakort që njoftimet duhet të bëheshin më parë, kjo është situata tani jemi në mes të sezonit unë nuk shoh ndonjë problematikë për bizneset, nuk ja kam matur xhirot por duhet të kemi parasysh atë që thashë në fillim që bulevardi nuk ju takon vetëm bizneseve por gjithë qytetit, në rast se dëmtohet pak dikush dhe fitojnë shumë disa të tjerë kjo është një balancë që për mua ja vlen të vazhdojë të mbështetet, çfarëdolloj mase që kenë për vitin tjetër na thonë ta kemi parasysh.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më falni do ju kërkoja ndjesë të largohem sepse nuk ndihem mirë jam e sëmurë dhe të vazhdojë Eda.

Këshilltar L.Petri: Të shkuara znj.kryetare.

Këshilltare E.Mitre: Nëse nuk kemi diçka tjetër me këtë pike, të vazhdojmë, po z.Klajdi.

Këshilltar K.Pllaha: Deri kur është planifikuar të vazhdojë kjo masë dhe nëse më lejon ta mbaroj si diskutim, unë mbroj në parim të drejtën e atyre bizneseve për tu konsultuar për të parë nevojat e tyre, sepse është përmendur edhe tek shkresa që këta biznese paguajnë deh tarifën e parkimit që ju del jashtë funksionit për 3 ore në ditë.

Këshilltare A.Përmeti: Tarifat janë me orar.

Këshilltar K.Pllaha: Ata paguajnë taksë për të pasur një parkim të dedikuar për biznesin, nëse ata paguajnë gjatë gjithë ditës dhe 3 orë ja u heq të drejtën ka një ngërç, plus fakti që në pjesën e parkut nuk lejohet parkimi kurse në Bulevard "Republika" mund të parkosh dhe ato makina që janë të parkuara mund të levizin duke hyrë nëpër rrugica.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ky vit është vit i parë kur ne po shohim dhe nuk po jemi shumë strikt me gjobitjen e makinave që janë atje dhe ato që kalojnë kryq, jemi duke parë sesi po reagon trafiku dhe çfarë problematikash po krijohen në këtë rregjim që jemi, do i shohim do i mbledhim këto problemet he vitin tjetër besoj do kemi një skemë më të mirë, këtu pres edhe opinionet tuaja dhe kërkesat patjetër të bizneseve por gjithmonë duke marrë parasysh faktin se k yaks në periudhën e verës do jetë pa qarkullim nga makinat , për sa i takon periudhës do jetë i njëjti rregjim si për parkun Rinia deri në 15 shtator mos gaboj, atje tek parku e kemi 18:00-22:00 këtu e kemi 19:00-23:00 mund ta bëjmë edhe atë të parkut deri në 11:00 bën sens të shihet si një aks i vetëm.

Këshilltare E.Mitre: Faleminderit, po z.Petri.

Këshilltar L.Petri: Edhe një sygjërim tjetër që më lindi nga diskutimet, do e konsideroj në makro për gjithë qytetin sepse lëvija konsumatore përsëri duke e parë në këndvështrimin e biznesit jam dakort që bulevardi dhe qyteti më parë është i qytetarëve por dhe ata qytetarë janë sipërmarrësit sepse sjellin vlerë dhe punësojnë njerëz dhe sjellin shërbime, kam marrë ankesa nga sipërmarrësit e pedonale që kur u mor ky vendim rrjedha e njerëzve shkonin tek parku ra konsumi në pedonale pasi shkonin drejt parkut dhe bulevardit, kështu që duhen parë edhe këto shkak pasojat që vijnë në një qytet relativisht të vogël siç jemi ne.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po e filloj nga kjo e fundit për mua personalsiht si individ, në një qytet të madhësisë që ka Korça që fatmirësisht konsiderohet nga ato qytete të ecshëm në këmbë, sa më teër të ketë hapësira pedonale aq më mirë është dhe unë nuk mund të shkoj me logjikën të le vetëm një

aks pedonal të mbledhen njerëzit atje dhe gjithëandej të lejoj trafikun e makinave. Për mua duhet të ketë akoma më shumë akse për këmbësorë, këtë e kam si parim timin nuk e di a e ndajmë bashkë me Këshillin, kot i nxjerrin makinat një pjesë sa harxhojnë lekë dhe ndotje kot. Përsa i takon kësaj pjesës që po ikin njerëzit në drejtim të parkut njerëzit e zgjedhin vetë nga të shkojnë nuk mund të mbyll akse.

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar A.Përmeti: Të shtoj diçka për Lazjonin nuk bëhet fjalë për njerëzit që do ikin këtej apo andej, ata njerëz që do ikin nga parku do ikin dhe në përgjithësi janë nëna me karroca ose të moshuar dhe ata xhiron do e bëjnë deri në parku përsëri, përsëri ti mund të kesh akses sepse rrugicat janë të aksesueshme.

Këshilltar E.Mitre: Në fakt ne jemi ata që duhet të ankojemi sepse kemi shtëpitë aty dhe në momentin që rrugicat janë të aksesueshme unë mendoj se dhe këto bizneset, bizneset e Bulevard "Republikës" e kanë aksesin edhe për njerëzit, unë nuk kam shkuar ndonjëherë në kafe me makinë, shkoj në këmbë, ta kuptojmë pak edhe si qytetar sepse nuk mund të marrim makinën edhe për të blerë perime.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani Erald jo nga unë por me statistikë nga ky drejtori i qarkullimit rrugor 90% e makinave që lëviznin në Bulevard "Republika" ishin makina që xhironin kot, në rast se unë e kisha perceptim ai më tha sepse u ulëm në tavolinë kur e kam diskutuar e kam matur për një periudhë kohore, po flasim për këtë 10 % që po rregullohet me mënyra të tjera.

Këshilltar E.Bregu: Ky ishte një takim formal apo informal, kishte lidhje me çështjen, ka qënë takim informal i organizuar për këtë çështje që të marrësh informacion që të dish se çfarë do vendosësh?

Këshilltar E.Fejzulla: Të gjitha vendimmarrjet kanë anë të mira dhe të këqija ne na shijon ta bëjmë atë xhiron në këmbë, por bizneset meqënëse kanë erdhur dhe kanë bërë kërkesën nuk janë të kënaqur nga kjo gjë, por për mua problematikë më e madhe tani gjatë kulmit të sezonit turistik sepse po shkojmë drejt kulmit sa më shumë afrohet Festa e Birrës rritet trafiku dhe duhet parë me shumë vëmendje pjesa e trafikut tek bulevardi poshtë por edhe nëpër qoshka dhe në Lagjet 12,1,2,3 sepse do kthehet në problem shumë të madh dhe kjo gjë duhet verifikuar, duhet ndjekur, nëse do mundet ta përballojnë trafikun e atyre ditëve këto bulevardet duke mbyllur bulevardin poshtë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani përsa i përket rregullimit të trafikut të qytetit të Korçës përfshirë lëvizjen e mjeteve, të këmbësorëve, të parkimeve ne kemi fituar një projekt me fondet e Bashkimit Europian në kuadrin e të cilit do hartojmë një plan në menaxhimin e trafikut në mënyrë profesionale për qytetin e Korçës dhe besoj do i japë përgjigje gjitha pyetjeve, kemi parë në qytete Europiane ku në zona të caktuara ti nuk hyn dot me makinë, lejohet vetëm banorët e atyre zonave, duhet të parkosh në zonën rreth e rrotull që është goxha zonë e madhe dhe duhet të ecësh në këmbë pastaj, nuk është kjo kultura Shqiptare ku duhet të parkosh 10 m në rreze të vednit ku jeton, do parkosh ku janë vendet e parkimit dhe distanca sa është gjithë Korça atje është pedonale dhe duhet të shkosh në këmbë të mbarosh punë por nuk jemi në atë zonë, po flasim për një zonë të vogël ku duhen evidentuar problemet dhe tu jepet zgjidhje.

Këshilltar A.Përmeti: Më fal duhet të ketë në dy anët tabela informuese sepse nuk ka janë vetëm ato piketat, në fillim e kuptuam se çfarë ka mos bëhet ndonjë aktivitet. Mirë do ishte të kishte një tabelë informuese dhe në periudhën kur, sa më shumë informacion ka aq më mirë është, sepse unë kam pallatin atje dhe e shikoj, mirë është të ketë një tabelë informuese, ka një ndërgjegjësim

automatik të atyre që nuk kalojnë dot. Mbase në kuadër të kësaj unë e kam ngritur disa herë sinjalistikën vertikale të zonës historike të cilat vazhdon të jetë e shkatëruar dhe mos respektohet nga makinat hyrse dhe dalëse dhe na është thënë që pritej një plan që duhet të vijë nga urbanistika nshp-së e cila duhet ta zbatojë. Mirë do ishte mos ngelej vetëm në diskutim por të merreshin masa për këtë pjesë, gjithashtu të vendosen edhe table treguese sepse një turist që nuk e përdor googlemaps sepse nuk ka internet, mund të shikojë tabelat treguese se ku duhet të shkojë nga qendra ku ndalon tek kulla, mund të shkosh tek muzeu të cilat mund të shikohen edhe këto.

Këshilltar E.Fejzulla: Një pyetje që më erdhi tani për të parë nivelin e ndotjes të ajrit në momentin që kemi marrë këtë masë, ka përmirësim dhe në këtë mënyrë ndërgjegjësohen edhe qytetarët ?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e kemi parë por nuk do ndonjë filozofi të madhe që në momentin që limitohen makinat, minimalisht familjet që banojnë në atë aks na urojnë të gjithë sepse kishin zhurmë, tymra makinash, nuk e kemi matur në mënyrë profesionale.

Këshilltare E.Mitre: Nëse nuk ka diçka tjetër kalojmë tek propozimi që bëri z.Petri në krye të mbledhjes diskutim për zonën pedonale.

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Prej disa ditësh ka filluar edhe në qytetin e Korçës ndërhyrja për lirimin e hapësirave publike, ky aksion ka dy ndërhyrje kryesore. E para është lirimi i hapësirave publike të zëna nga bizneset dhe ndërhyrja e dytë është lirmi dhe sistemi i hapësirave publike kryesisht i zonave me pallate të zënga nga individët kryesisht katet e para me gardhe, këtyre ndërhyrjeve ju bashkohet edhe një ndërhyrje e tretë për sistemin dhe rregullimin e kablove të telefonit dhe internetit në qytetin e Korçës. Tani pyetja specifike ishte për ndërhyrjen e parë. Tani pak historik unë kam pasur një takim me pjesën më të madhe të bizneseve në zonën këmbësore, takim rreth 1 orë e gjysëm, kemi diskutuar dhe ja u kam bërë edhe atyre historikun që do ju bëj edhe ju, meqëse i kam ndjekur dhe kam qënë në Bashki që në fillimet e pedonales dhe deri tani. Investimi tek zona e pedonales është kryer në vitin 2011 në mos gaboj, ku ky aks u transformua nga një zonë kalimi për makinat në një zonë këmbësore dhe në atë periudhë u inkurajua një pjesë e madhe e bizneseve që të shihnin mundësinë nga ato aktivitete që kishin në aktivitete të karakterit të bareve apo restoranteve, që në ato momentet e para u lejuan elementët që u lejuan edhe sot që ishte vendosja e çadrave edhe karrige dhe tavolina jashtë lokalit pa bërë ndërhyrje shtesë në pedonale. Këto ndërhyrje filluan më vonë dhe kulmuan me futjen në fuqi të ligjit të duhanit ku këto hapësira u panë si hapësira për t'ju shmangur zbatimit të ligjit dhe për të pirë duhan në ambiente 90% të mbyllura. Nga ana e Bashkisë asnjëherë nuk janë inkurajuar bizneset që të bëjnë ndërhyrje të kësaj natyre ja u dhashë edhe bizneseve, madje ka disa vite që jo vetëm që nuk janë inkurajuar por kanë pasur dhe janë penguar diku me sukses diku me teççerek sukses që të vazhdonin me struktura të tipit të kishim ndërhyrë më parë. Këtë ndërhyrje ne do e fillonim edhe sikur mos ishte kjo iniciativa e kryeministrit në nivel vendi dhe këtë e dinë edhe bizneset ja u kam thënë edhe në sy, ju kam thënë këtu e disa vjet që kemi hyrë në drejtim të paditur nuk mund të trajtohet pedonalia me këtë kjoskëzim të kësaj natyre dhe ne do ndërhyjmë me një projekt të rikthimit të pedonales në situatën që ka qënë më parë, diku nuk i kemi lejuar duke u bërë të padrejtë me disa biznese dhe me të drejtë sepse theshin që ata pse i lejon dhe ne jo, ne ju kemi thënë që ne do ndërhyjmë në një moment dhe nga të gjithë në momentin që kam komunikua unë më është thënë në momentin që do ndërhysh ne do i heqim këto struktura që kemi vënë, kjo ka qënë situata e marrëdhënies time me pedonalen, nuk i kam nxitur më kanë thënë kur të vijë momenti do i heqim vetë, dhe nga leja e përkohshme ju kemi vënë një pikë që

nga momenti i ndërhyrjes nga ana e Bashkisë me ndonjë projekt janë të detyruar ti lëvizin vetë strukturat, kjo është historia. Tani ka filluar një aksion kombëtar për lirin e hapësirave publike që unë i përshëndes na i lehtësoi punën sepse unë kisha filluar aksionin vetë me një studio për të liru hapësirën publike ky aksion i vuri në nivel kombëtar duke hequr vazo, dhe do ketë vetëm çadra dhe sqaroj deh hapësirën. Në momentin që kam qënë i qartë kam kontaktuar bizneset dhe kemi bërë diskutimin deri në një farë mase konstruktiv sipas meje pastaj në fund degradoi dhe nuk u morën parasysh as ato për të cilat kishim rënë dakort deri në ato moment, nuk e kam në natyrë të jem arbitrar dhe i padrejtë, i kam dëgjuar ja u kam ripërsëritur dhe ja u kam treguar me gisht bizneseve që kanë rënë dakort atëherë, e kanë pranuar dhe vetë. Tani jemi në këto kushte, e para ajo është hapësirë publike dhe është në tagrin e administratorit të asaj hapësire publike që është Bashkia që caktoi rregullat e përdorimit të kësaj hapësire kuptohet për sa kohë që nuk ka rregulla nga një organ më e lartë që është qeveria, si parim teorik mund të ketë vendimmarrje që mos ketë fare karrige dhe tavolina në pedonale, debate degradoi sikur po vendosja rregulla në oborrin privat ndërkohë po vendosja rregulla në pronën publike dhe këtu fillon historia, këto elementët e mobilimit urban janë të përcaktuara në kuadër të përgjithshëm në gjithë Shqipërinë që do jenë vetëm çadra dhe tavolina. Përjashtimisht nga ky aksioni kombëtar që ka të tjera afate meqënëse jemi njerëz që komunikojmë dhe dëgjohejmë dhe përpiqemi ti kuptojmë shqetësimet po përpiqemi të vendosim datën 17 gusht por deri atëherë ju do hiqni të gjithë elementët e hqeshëm dhe do lini vetëm tendën dhe tavolinat kurse në datën 18 do vini çadrat sipas modelit që përsëri i pyeta se kush është modeli i përshtatshëm për sa kohë nuk ka ndonjë model, kjo ka qënë historia e diskutimit dhe kjo është historia e vendosjes të këtyre strukturave në zonën këmbësore, ju kam thënë që kjo ditë do vijë dhe kam qënë shumë i arsyeshëm. I ftoj mos harxhojnë kot ditët deri në datën 2 që kanë afatin për të hequr këto elementët që mund të hiqem dhe tendën vetëm ta heqin në datën 18.

Këshilltari E.Mitre: Ka diçka nga këshilltarët?

Këshilltari E.Bregu: Gjatë gjithë periudhës që është investuar dhe janë vendosur platforma të çmonuteshme por që zënë hapësirat dhe janë investim me vlerë të lartë kam përshtypje që atje ka pasur disa projekte siç është Bid apo organizata të tjera që kanë financuar me vlera monetare ndërtimin e këtyre strukturave. Pyetja e parë është e vërtetë kjo apo jo?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po është e vërtetë se zona e Pazarit bashkë me zonën e pedonale janë administruar, kanë ekzistuar dy shoqata Bid për zonën pedonale dhe Tid për Pazarin, të cilat janë mbështetur me buxhet edhe nga Bashkia edhe nga donatorët për të kryer një sërë investimesh të vogla apo aktivitetet në këto zona por asnjë nga buxhetet nuk është përdorur për investime individuale të bizneseve.

Këshilltari E.Bregu: Pyetja tjetër ka të bëjë me faktin se duke qënë se ato kanë mbi 10 vjet ekzistuese pjesa më e madhe se mbase dikush mund ta ketë bërë vitin e fundit investimin, a ndjen përgjegjësi Bashkia që i ka lejuar këto hapësira të zihen?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani në rast se më dëgjove në ajo që unë paraqita, unë ju përgjigja kësaj pyetje.

Këshilltari E.Bregu: Ndoshta nuk të kam dëgjuar me shumë vëmendje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk më ke kuptuar mbase se po je këtu dhe po flasim me mikrofoni dhe nuk e ke vëmendjen pse je këtu atëherë dhe më pyet për diçka që sapo e sqarova. Jo nuk ndihemi përgjegjës sepse nuk i kemi inkurajuar në asnjë moment të vendosin struktura të tilla, i kam

paralajmëruar që mos vendosin struktura të ngjashme me ato që ishin vendosur më parë sepse do vinte kjo ditë dhe sikur mos ishte ky aksioni kombëtar.

Këshilltar E.Bregu: Më fal mos u keqkuptuat sepse pyetje ime ishte i lejovë jo i inkurajovë, mund ta japësh përgjigje më të saktë ju lutem?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo nuk ndihemi përgjegjës sepse i kam paralajmëruar që do ketë një projekt për ta lehtësuar pedonalen nga këto elementët e tepër dhe për ta kthyer në origjinë dhe një pjesë e madhe e atyre që më kanë pyetur se një pjesë nuk më kanë pyetur në kuptimin ver njëherë një anësore 1 m e gjysëm, pasta mbylle fare, pastaj veri dhe një derë me çelës dhe bëje si qymez dhe ata që më kanë pyetur ju kam thënë e ardhmja e pedonales nuk është kjo do kemi një projekt për ndërhyrje edhe ma kanë thënë me gojën e tyre që kur të vijë ajo gjëja për të gjithë do vijë edhe për ne dhe për hir të së vërtetës këta 4 që tregova me gisht e pranuan.

Këshilltar E.Bregu: Kur e ke fjalën të kanë pyetur, të kanë pyetur në mënyrë miqësore apo të janë drejtuar zyrtarisht?

Nëse të kanë pyetur në mënyrë miqësore pse i ke trajtuar në mënyrë preferenciale ka ndonjë lidhje apo influence të pa ligjshme?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk ka asnjë trajtim preferencial mbi baza miqësie përkundrazi qëndrimi im u bë kategorik në vitet e fundit kur fenomenin u bë jashtë zakonisht shqetësues dhe në këtë moment edhe janë ndaluar bizneset tani i shikoni vetë edhe janë ndaluar edhe janë paralajmëruar që mos vazhdoni në këtë drejtim sepse ne do ndërhyjmë dhe po erithem edhe njëherë ky aksion në pedonale jo gjithë qytetin t'i themi gjërat siç janë por të paktë në pedonale ky aksion do bëhet dhe sikur mos ishte aksioni kombëtar, kisha folur me një arkitekt sesi do i vendosnim mobilimin urban por ky aksion na i lehtësoi punën dhe këtë faktin e ndërhyrjes në pedonale gjithë e kanë ditur dhe ata që më kanë kontaktuar dhe ata që nuk më kanë kontaktuar se Korça aq është e dinin se plani i Bashkisë ishte për t'i sistemuar.

Këshilltar E.Bregu: Më fal sepse nuk ju përgjigje pyetjes të kanë pyetur në mënyrë miqësore apo të janë drejtuar zyrtarisht, sepse ata kanë bërë një investim si biznes paguajnë taksa, marrin lejë dhe dua ta di sepse vetë the më kanë pyetur.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më kanë kontaktuar në pozicionin e kryetarit të Bashkisë, jo me letër por më kanë kontaktuar në zyrë dhe e quaj zyrtarisht dhe ja u kam thënë jo si qytetar por si kryetar dhe i dinë mund t'i takoni dhe vetë dhe kush thotë që nuk e di, ok.

Këshilltare L.Alidinaj: Meqënëse thatë se jeni në kuadrin e përmirësimit të shtyllave është një rast në rrethrotullimi i Ersekës është një kabël i erësuar përballë me lokalit Barba, më duket se janë linjat e tensionit dhe pjesa e lumit atje është e mbuluar me barishte të mëdha, nëse NSHP mund të ndërhyjë për të bërë një pastrim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ajo ndërhyrja për të cilën unë fola lidhet me sistemimin e kabllave me sistemimin e kabllave të kompanive të internetit dhe televizorit jo kabllave të korrentit, nuk e di çfarë kabli është. Aksioni ka nisur nga Lagjia 12 dhe do shtrihet në gjithë qytetin, aksioni konsiston me heqjen e gjithë kabllave që janë jashtë funksionit sepse nga ajo që kemi parë 40 % janë jashtë funksionit, do hiqen si fillim gjithë kabllo të cilat janë jashtë funksionit dhe ato që janë në funksion të sistemohen sa më mirë, të kapen në një kabël të vetëm, kjo është ndërhyrja por do pak kohë sepse dhe ritmi është i ngadaltë për shkak të forces punëtore.

Këshilltar L.Petri: Dua ta falenderoj z.kryetar për kronologjinë që bëri edhe që ndau me ne takimin me sipërmarrësit e pedonales, dua të jap edhe unë mendimin tim sepse ka disa element që nuk u thanë. Fjala vjen aty thuhet se nuk janë inkurajuar bizneset për ato struktura që ai i quajti si kjoska si kjoska të pedonales ndërkohë që ne e dimë se për sipërmarrjen e Helzagut u duartrokrit dhe u tha se kështu është shembulli dhe kështu duhen bërë të gjitha dhe sot ishte Helzagu që i ka hequr.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal të të ndërpris pak, nuk e di nëse ke muhabet me pronarët e helzagut në rast se nuk ke muhabet shko dhe thuaj e ke takuar kryetarin e Bashkisë në zyrë dhe çfarë të ka thënë?

Ka qënë një nga rastet që edhe pse i kam thënë jo nuk është kjo mënyra sesi investohet dhe më ka thënë se ajo që unë do bëj është më transparente se këta të tjerët dhe kur të vijë momenti që të ndërhysh në gjithë pedonalen unë do jem i pari që do i heq, shko edhe pyete.

Këshilltar L.Petri: Faleminderit, unë besoj tek fjala jote.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kur e them diçka e them me përgjegjësi, nuk kam inkurajuar asnjë.

Këshilltar L.Petri: Unë si qytetar di që në nivel horizontal për sipërmarrjet rreth e rrotull është marrë si etalon ajo sipërmarrje, ne jse qofsha i gabuar. U tha nga ju z.kryetar që na vlejti ky aksion kombëtar sepse ka thjeshtuar punën dhe ka krijuar standarte dhe u tha gjithashtu nga ju me apo pa këtë aksion kombëtar ne do e bënim këtë ndërhyrje sepse kemi një projekt dhe po punojmë për një projekt që të rregullohet standarti i kësaj hapësire private me atë publike. Pse duhet ky hulumtim 4 ditor që ju bëhet sipërmarrësve me vulën e Bashkisë dhe firmën tuaj kur ju keni një projekt, pse nuk është bërë me dije ky projekt, pse nuk është konsultuar me këta aktorë që janë aktorë kyç, nga një anë na rezulton se ju keni një projekt dhe nga ana tjetër.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani sepse vetë po e thua me gojën tënde dhe nuk po kupton çfarëthua, ke 1 projekt dhe po punon për 1 projekt janë dy gjëra të ndryshme, ke një projekt e ke të bërë dhe po punon për një projekt është një projekt që nuk e ke akoma, tani e kupton dallimin midis dy koncepteve?

Nuk e kisha një projekt e kisha filluar punën për të bërë një projekt mund ta them veçant me këtë, propozim për të lehtësuar pedonalen nga këto elementë të bërë në kohë dhe nuk e kisha.

Këshilltar L.Petri: Pse kur jeni në proces pune e gjeni të vështirë që të kundërshtoni urdhërin e kryeministrit apo një frymë kryeministore kur ju jeni i zgjedhur z.kryetar jo i emëruar, jeni i zgjedhur ti përfaqësoni denjësisht qytetarët e Korçës si për ata që të kanë zgjedhur dhe ata që nuk të kanë zgjedhur dhe fare mirë keni tagrin që dhe z.kryeministrit ti tregoni se po jemi për një standart European të sipërmarrjeve për hapësirat publike por edhe ne kemi afatet tona si bashkëpunojmë me komunitetin, kështu që i dilni zot kësaj pune, zhgënjimi më i madh ndaj qytetarëve përveç kostos të kohës me ngut dhe në momentin ndaj qytetarëve përveç kostos të kohës me ngut dhe në momentin që u bë në kohë sezoni është mënyra si u bë dhe ju i kthyet shpinën.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e di me këtë biznes ke folur dhe të ka shprehur gjithë këtë zhgënjim por me një ide që mund të kem besoj se dhe ai zotëria, ai djali është nga këta të cilët e kanë këtë informacion për planet e Bashkisë për të ndërhyrë në pedonale, është një nga ata që mos gaboje e kam takuar, më ka erdhur në zyrë që pavarisisht këtij aksioni kombëtar Bashkia do bënte një ndërhyrje për lehtësimin e elementëve të përdorur në hapësirë publike, kam qënë dhe shumë i

hapur për të lënë afate. Ju thashë se tendat mund t'i mbani deri në datën, ju kam thënë se deri në datën 2 të hiqen këto elementët ndarës dhe nuk kërkojnë ndonjë investim dhe në datën 18 të heqin tendat të venë çadrat, nuk kam qënë strikt, deri në datën 2 të heqin platformat.

Këshilltar E.Bregu: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.) Unë kuptova sikur ti ju dhe kohë atyre po mesa kuptova kjo është një gënjeshtëri, thjesht po na gënjen në këtu, po hoqe bazën ku qëndrojnë ato?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pse more zjarr kështu, do dëgjosh tani përgjigjen?

Këshilltar E.Bregu: Çfarë të dëgjoj na gënjeve deri tani?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: U ktheve në skenarin sepse kishe qënë i qetë disa kohë, na kishte marrë malli.

Këshilltar E.Bregu: Në atë skenarin që nuk jep informacion për Ekipin e "Skënderbeut", që nuk lejon të ngrihet komisioni hetimor, për kë skenar e ke fjalën?

Ky është skenari që ne të durojmë, të presim dhe ti nuk vepron qëllimisht.

Këshilltar E.Mitre: Më fal z.Bregu, ta mbyllim këtë mbledhjen kështu normalisht dhe jo duke thirrur, ju lutem.

Këshilltar E.Bregu: Kalofshi mirë!

Këshilltar E.Mitre: Edhe ti kalofshi mirë, faleminderit për prezencën.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Afati i datës 2 ka qënë për ato elementë që hiqen lehtësisht dhe nuk duan investim dhe ju kam thënë datës 2 ka qënë për ato elementë që hiqen lehtësisht dhe nuk duan investim dhe ju kam thënë se tendat meqënëse çadrat duan 2 javë të prodhohen, të hiqen në datën 18. Përsa i takon raportit kryetar bashkia-qeveri në lidhje me vendimmarrjet, tani ne patjetër jemi një organ i pushtetit vendor, edhe unë jam kryetar Bashkie I zgjedhur nga populli por në ushtrimin e detyrës time jam i detyruar të zbatoj udhëzime, kuadër ligjor, ligje që lëshohen nga 1 institucion që është mbi mua sipas Kushtetutës dhe Qeveria është mbi Bashkinë në Kushtetutë që do të thotë edhe për menaxhimin e hapësirës publike Qeveria ka tagër të nxjerrë udhëzime, urdhra, vkm sesi administrohet kjo hapësirë publike dhe unë jam i detyruar t'i zbatoj ato në rast se nuk ka ndonjë vendimmarrje nga organet më lart rregullohemi brenda për brenda, për disa gjëra është kompetenca ime, për disa gjëra duhet ta ndaj me Këshillin e Bashkisë. Në rastin monokret nd, për disa gjëra duhet ta ndaj me Këshillin e Bashkisë. Në rastin monokret ndërhyrja atje do bëhej dhe kjo iniciativa në nivel vendi më shërbeu për të marrë këto elementët e mobilimit urban çadra, karrige, tavolina.

Këshilltar L.Petri: Më fal, po thoni se ka vkm për këtë gjë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër që ka bazë ligjore që ekziston, që po del, ka edhe iniciativa të Qeverisë që do përkthehen në bazë ligjore, tani ti preferon që unë bizneseve, tani unë prandaj mora pak kohë sepse doja ta kuptoja qartësisht atë standartin që do zbatohet në nivel vendi sepse nuk do preferoja që bizneseve në një moment t'ju vihej një standart i caktuar dhe më pas t'i prishnin sërisht, kam qënë shumë i kujdesshëm, në ato gjëra që ka hapësirë kam qënë shumë bashkëpunues i dëgjova ato hapësirat e logjikshme dhe i pyeta për llojin e çadrës, por diskutime të tipit po hoqa pedanën më ikën tenda që nuk e di si ikën, ato janë pastaj histori kot më shumë argumenta që ja nuk na dëgjojnë dhe do dalim të protestojmë.

Këshilltar L.Petri: Z.Kryetar po çadrat do jenë të njehta apo secili do i blerë sipas vetes?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po dakortësuam për dy modele çadrash ngjyra do jetë e fiksuar, sot bëme edhe një llogaritje të sipërfaqes që do ketë çdo biznes, pak a shumë në sipërfaqe që janë, me përjashtim të dy zonave që unë e kam konstatuar probelamtikë dhe duhet të reduktohet sipërfaqja dhe tani do ja u japim dhe duhet të vendosin çadrat që përputhen me këto dimensione.

Këshilltare E.Mitre: Faleminderit, po z.Pllaha.

Këshilltar K.Pllaha: Pjesa më e madhe e bizneseve ka pasur leje për shfrytëzim teritori për përdorimin e hapësirës publike por nuk kanë pasur leje për ngritjen e strukturave provizore dhe kjo është shkelje nga ana e tyre por edhe nga ana e Bashkisë, duke qënë në dijeni se po ngrenë strukturat të cilat kanë nevojë për leje ndërtimi provizore apo ku di unë, këtu jemi në shkelje nga të dyja palët, nuk mund ta kalojmë këtë me faktin që nuk i stimuloam por kemi lejuar të bëjmë një shkelje sepse kjo në vetvete përbën shkelje. E dyta për të mos u fokusuar vetëm në 0rështjen e pedonales sepse kjo prek shumë zona të qytetit edhe Bulevard "Gjergj Kastrioti", ku bizneset po heqin strukturat e tyre. Pyetja ime është këto lejet e shfrytëzimit të teritorit që janë pezulluar për momentin, kur mund të rifillojnë, në rast se ata e kthejnë në standart?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Lejet janë shfuqëzuar dhe ata do pajisjen me leje të reja ku do kenë edhe hapësirën, edhe elementët e mobilimit të standartit urban, do lejohen vetëm çadra, jo elementë ndarës, jo kjoska dhe mund të vazhdojnë menjëherë sa të adoptojnë standartin e ri, nuk do kenë ndonjë kohë bosh, të bëjnë ndërhyrjet për tu përhstatuar me standartin e ri dhe të vazhdojnë.

Këshilltare E.Mitre: Pika e fundit nga kërkesa-ankesa është kërkesa e znj.Rabian Dyli për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit, ndërkohë që unë dua t'ju bëj me dije se komisioni i mirëqenies sociale shkoi për verifikim së bashku edhe një grup këshilltarësh, z.Lazjon, z.Klajdi dhe unë shkua për të dyti dhe nuk mund të gjenim njerëz atje kemi përpiluar një raport të thjeshtë në bazë të atyre hapave që duhen bërë dhe ja kemi dërguar kryetarit me email dhe besoj se ju kryetar e keni marrë. Ne kemi paraqitur në raport thjesht ato ç'ka pamë ne.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal nëse mund të na i ndani kush janë këto gjetjet e raportit meqënëse është dhe Rabiani këtu. Për ta ripërsëritur edhe njëherë kërkesa e Rabianit është që në një apartament dhomë + kuzhinë është vendosur një familje e cila nuk banon atje, kjo familje e paguan rregullisht qeranë sipas drejtoreshës dhe ajo nuk ka patur fakte se kjo familje nuk banon atje. Rabiani pretendon se familja nuk është, detyra që mori përsipër Këshilli ishte të ngrinte një grup ta verifikonte dhe të vinte këtu e të na thoshte po objekti nuk përdoret nga familje X ose po përdoret. Në rast se ishte në rastin e parë vetë këtu në Këshill do jepnim një vendimmarrje për t'ja hequr asaj familje atë apartament dhe në momentin që apartamenti do lirohej do shqyrtohej përsëri këtu në këshill mundësia për t'ja dhënë Rabianit. Jemi në këto kushte?

Këshilltare E.Mitre: Të dyja herët që kemi shkuar kemi verifikuar se nuk ka asnjë në banesë, por ne nuk mund të kontrollojmë dot faturat e ujit dhe dritave sepse nuk gjen dot njeri.

Këshilltare A.Taho: Në datën 30 qershor shoqëruar nga dy anëtarët e komisionit Edlira dhe Ornela ne kemi shkuar pranë këtyre banesave kemi telefonuar znj.Rabian dhe as ajo nuk na është përgjigjur. Jemi munduar që të kontaktojmë komshinjtë në pallat por ka qënë e pamundur, më kanë informuar Eda që e ka përsëritur vizitën me dy këshilltarë dhe ejmi në të njëjtën situatë, ne nuk po mundemi dot t'ne nuk po mundemi dot të marrim informacion për këto familje, duke qënë se është dhe sezon pushimesh kemi menduar se janë larguar me sezon pushimesh. Përsa i përket vizitës së

vjetshme unë e kamë thënë edhe dy mbledhje më parë që ne komisioni prej 4 anëtarësh dhe i kemi takuar, këto herët e fundit nuk kanë qënë.

Qytetaria R.dyli: (Nuk ka audio.)

Këshilltare A.Taho: Ky ishte informacioni që doja të ndaja me kolegët këshilltarë por edhe Rabiani besoj e di këtë situatë, ne e kemi kontaktuar dhe vetë Rabiana nuk ka qënë në shtëpi ne nuk mund të themi se dhe znj.Rabian nuk jeton në atë shtëpi, edhe me dy familjet e tjera ne kemi foto gjatë vizitës, ky është informacioni që ndaj me këshilltarët.

Këshilltare L.Alidinaj: Kam qënë dhe unë herën e parë dhe atje gjetëm njerëz por mund të them kështu meqënëse jemi në këtë situatë atje verifikohet shpejt konsumi i ujit, i dritave.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kontratat i kanë individuale por ne si Bashki mund të kërkojmë informacion tek operatorët dhe të na venë në dijeni vetëm na thonë sepse nuk mund të merrem orë e sekondë me Rabianin sepse ju keni shkuar dhe nuk keni gjetur asgjë, ideja është që nga ana e komisionit dhe e Këshillit ne presim një vendimmarrje të tipit e verifikuam, ata nuk banojnë atje po abuzojnë kot ta llojmë dhe të banojnë familje të tjera, nuk po them se është kjo por presim o këtë o është e zënë sepse tek stafi ynë kot ta llojmë dhe të banojnë familje të tjera, nuk po them se është kjo por presim o këtë o është e zënë sepse tek stafi ynë Rabianu nuk ka besim nga stafi i Bashkisë dhe e kërkoj nga Këshilli.

Këshilltar K.Pilaha: Për hir të së vërtetës herën e fundit që isha dhe unë një nga komshinjtë tha se banesa përdoret për nënkontraktim, pra ai që e ka marrë e lëshon me qra më afatshkurtër dhe kjo është shkelje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër që është shkelje por verifikoheni, (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltare A.Përmeti: E para unë si Ada nuk do votoj për këtë pikë sepse ne si Këshill nuk mund të hyjmë në një konflikt, a e kemi ne tagrin të hyjmë dhe të cënojmë privatësinë e një personi tjetër kur normalisht kjo bëhet o me një denoncim ose me diçka juridike, ne si Këshill nuk mund të shkojmë. Me çfarë tagër shkojmë ne dhe cënojmë privatësinë e një familjeve, duhet të kemi kujdes kur ndërmarrim vendimmarrje të tilla dhe duhet të konsultohemi ligjërisht sesi veprojmë për këtë pjesë qoftë pozitive apo negative por mund të hyjmë në konflikte ku nuk kemi tagër dhe mund ta ndiejmë veten para një gjyqi, kështu që unë si Ada e shoh shumë sensitive këtë pjesë dhe përfshirjen e Këshillit Bashkiak në këtë drejtim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në rast se ai apartament është marrë dhe përdoret me nënkontraktim kjo është një shkelje, shkelje ligjore e kontratës dhe duhet ta ndërpresim kontratën me këtë individ. Puna është se ne si administratë e Bashkisë nuk e kemi konstatuar këtë gjë të paktën nga zyra ime dhe nga Rabiani zyra ime është e paragjykuar pasi ajo thotë se nuk kam besim tek drejtoresha e Bashkisë që jep informacion direkt. Në rast se ju e verifikoni dhe thoni se nuk banon asnjë njeri ose banon ama vetëm në rast se ju e verifikoni unë nuk besoj se bëjmë një shkelje ligjore nëse marrim vendim në Këshill por duhet të jetë e verifikuar.

Këshilltare E.Mitre: Ne nuk mund të bazohemi tek fjalët e komshies pasi ajo as emrat nuk i dinte.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të thëresim përfituesit.

Këshilltare A.Taho: Para disa muajsh ne kemi sjellë edhe foto të dy banesave ku kemi gjetur familje, kanë qënë dy herën e parë dhe ne i kemi shoqëruar me foto.

Qytetaria R.Dyli: (Nuk ka audio.)

Këshilltare E.Mitre: Rabian të lutem ajo po thotë atë që pa.

Këshilltare A.Taho: Ne nuk kemi bërë asgjë gabim, kemi bërë detyrën tone. Unë nuk po kundërshtoj atë që thua ti, unë po bëj detyrën time.

Qytetaria R.Dyli: (Nuk ka audio.)

Këshilltare E.Mitre: Po shprehesh shumë gabim, nëqoftëse nuk donte t'ja dinte nuk do vinte dy herë. Nëse ka një zgjidhje dhe bëhet kjo që thotë kryetari t'i thëresim në ballafaqim ne jemi të gatshëm, mos thuaj nuk do t'ja dish.

Këshilltare A.Taho: Unë mendoj se nuk është kompetencë pasi siç e shikoni rabiani nuk është dakort me asnjë nga vendimet e Këshillit, mendoj që duhet t'i kalojë drejtorisë përkatëse të bëjë verifikimin dhe nëse ne kemi nevojë për fakte të tjera të jetë drejtoria ajo që t'i verë në dispozicion të Këshillit. Pjesa tjetër nëse do i kontaktojmë do ishte një zgjidhje për të marrë më shumë informacion.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund t'ja lemë si detyrë drejtorisë përkatëse, ti thëresë dhe në prezencë të komisionit të ngritur të Këshillit dhe të dëgjojë versionin e familjes tjetër sepse edhe kështu e gjen nuk e gjen, mund të jenë me pushime, mund të mos jenë as fare kjo që thotë Rabiani.

Këshilltare A.Taho: Njoftimi të jetë edhe për anëtarët e tjerë të Këshillit, janë pjesë e komisionit apo nuk janë, kur të bëhet edhe ky verifikim të jenë edhe anëtarët e tjera që të dakortësohemi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Eva mund ta mbash shënim t'i thuash të njoftosh Mirelen t'i njoftojë që në një datë të dakortësuar me komisionin e Këshillit të paraqitet për të sqaruar ambientin që ka me kontratë.

Këshilltare E.Mitre: Lazjon kishe diçka, edhe e mbyllim.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare e Këshillit unë i ndaj shqetësimet me kolegët që në rafsh jemi për t'i dhënë zgjidhje Rabianit por nga ana tjetër nuk dua të krijojmë precedentin sepse duke vepruar në këtë mënyrë krijojmë precedent. Unë jam dakort të kemi një ballafaqim me ata që zyrtarisht pretendohet sipas Rabianit që nuk jetojnë atje dhe sipas meje që me aq sa kam vajtur them që nuk ka, ose mu duk shumë e dyshimtë ajo fjala e familjes që këtu ndrohen fytyrat çdo muaj dhenuk ka një familje stabil dhe është shkelje mendoj se kjo do ishte rruga që u propozua nga kryetari.

Këshilltare E.Mitre: Dhe ne si komision bihem dakort me propozimin e kryetarit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sekretaria e Këshillit do lajmërojë drejtoreshën, ajo t'i lajmërojë të paraqiten që të jemi prezent edhe nga administrata dhe nga Këshilli. (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltare E.Mitre: Rabian je dakort?

Qytetaria R.Dyli: (Nuk ka audio.)

Këshilltare E.Mitre: E dëgjove Këshillin si tha ne nuk kemi ndërmend të përballemi gjykatave, kështu që do bëjmë këtë që tha kryetari. Faleminderit kryetar për propozimin, faleminderit këshilltarë, kalofshi mirë deri mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NACI



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI

